



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.697/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), me panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Junik, të paraqitur kundër Vjosa Pepshi nga Juniku, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 21.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.697/2021 e datës 18.10.2021, paraqitur nga Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Junik kundër Vjosa Pepshi nga Juniku, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit në ditën e votimit, për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

Me datë 21.10.2021, PZAP-i ka pranuar përmes postës ankesën Anr.697/2021 të datës 18.10.2021 nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, dega në Junik në të cilën pretendohet se Vjosa Pepshi nga Juniku, me vendbanim në Zvicër është në listën e votuesve jashtë Kosovës dhe ka votuar në Qendrën e Votimit VV 05R në Junik e po ashtu ka asistuar. Sipas parashtresës të ankesës dyshohet se e njëjta ka votuar përmes postës e po ashtu ka votuar edhe në Junik. Ankesës i ka bashkëngjitur një listë me emra në të cilët gjendet edhe emri i Vjosa Pepshit dhe një fotografi e printuar e komunikimit në mes të komisionerëve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës, gjeti se: Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljet e pretenduara, për parregullsitë në ditën e zgjedhjeve se Vjosa Pepshi, ka bërë votim të dyfishtë, Paneli i vlerësoi si të pabazuara, sepse ankuesi me asnjë provë shkresore nuk e ka provuara, që në rastin konkret shkelësi i supozuar ka votuar dy herë siç pretendon ankuesi, pasi që lista e bashkangjitur krahas ankesës si dhe komunikimi në mes të komisionerëve nuk vërtetojnë faktin se e njëjta ka bërë votim të dyfishtë pasi që ky është një komunikim jozyrtar ndërmjet komisionarëve, ne vendvotimin lëndor.

Andaj, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Junik, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, ku thuhet se *“Vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”* pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur një shkelje e tillë e pretenduar si në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.697/2021 më datën 21.10.2021



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.